



**INFORMACION I AUDITUESIT LIGJOR TË PAVARUR  
MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI**

Rruga Margarita Totolani Pall: 8 Shkalla 2/23 , Tirane

(Për periudhën 1 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018)

Shkodër, 28 QERSHOR 2019



**INFORMACION I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; me adresë : Rruga "Ibrahim Rugova" Tiranë, Albania.

**PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI**, OJF me adresë: Rruga Margarita Totolani Palli; 8 Shkalla 2/23 ,  
Tirane

**Informacion**

Ne nuk kemi kryer auditimin e pasqyrave financiare të Partisë: **PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI** ,  
OJF me adresë: Rruga Margarita Totolani Palli; 8 Shkalla 2/23, Tirane , me Perfaqesues Ligjor Z.Prengë Cuni .

Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga **PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI** Ne nuk mundëm të shprehim opinionin, mbi pasqyrat e pozicionin financiar të Partisë me datën 31 Dhjetor 2018, aktivitetet dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

**Baza për Informacionin**

Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga **PARTIA PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI**, Ne nuk mundëm të shprehim opinionin. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Informacionit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se në pamundësi të sigurimit të evidencës së auditimit nuk mund të japim opinion (\*) .

*(\*) Ne drejtim te **PARTIA PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE 8 NENTORI** kemi dërguar shkresë zyrtare me postë me kthim pergjigje respektivisht:*

*- Më datën 15 Maj 2019 kemi dërguar shkresën, me adresë Rruga Margarita Totolani Palli; 8 Shkalla 2/23 ,  
Tirane , me, Kodi i postimit RR 841 484 203 AA, për të cilën nga Posta Shqiptare na është kthyer përgjigja me  
datën 20 Maj 2017 me shenimin "Jeton familje ", kodi i postimit në kthim RR 841 484 203 AA*



- Më datën 21 Maj 2019 kemi nisur nje email ne drejtim te personelit te KOZ per te na ndimuar per nje adrese te re dhe nuk kemi marre asnje pergjigje .

Për shkresen tone është përdorur e njëjta adresë, e cila është marrë nga rregjistr i Partive Politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkangjitur kontratës të lldhur në mes Ekspertit Kontabël dhe K.Q.Z-së me nr 1365/1 dt.07.05.2019.

*Bashkelidhim ketij Informacioni kopjet e shkresave të derguara.*

### **Informacione të tjera**

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jop siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomal materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomal material, atëherë ne duhet të informojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të informuar.

### **Përgjegjësitë e drejtimt dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomal materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Partisë për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Partinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.



NR LIÇENSE 262 dt27/08/2012

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të Informacionimit financiar të Partisë dhe saktësimin e adresës së Partisë.


#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një Informacion auditimi që përfshin Informacionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Shkodër, më 28 Qershor 2019

Ervis Kraja

*Ervis kraja*  


AUDITUES LIGJORE